

2.08.2024

Ora, 21:17

**RENDI I DITËS**

**“Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 8. Subjekti ankues, zoti Arqilea Bollano, kryetar i komanduar i Bashkisë Himarë, me objekt: “Shfuqizimi i vendimit nr. 159, dt.1.08.2024 të KSHZ”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. Elvin Lako (online), z. Elvis Çefa, z. I. Rusmali, z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Znj. M. Koja, z. E. Mema.
- **Parti Politike:** BF (z. I. Kaso)
- **Të tjerë:** KRIIK

**Z. E. Çefa:** Mirëmbërma të gjithëve! Atëherë e deklarojmë të çelur seancën për shqyrtimin në themel të kërkesës ankimore me nr.8, të datës 2 gusht 2024, me subjekt ankimes Kryetarin në detyrë të Bashkisë Himarë, z. Arqilea Bollano. Verifikojmë prezencën, është prezent trupa e KAS-it, në shumicë. Për arsye objektive kolegu Bele nuk është, nuk do jetë prezent në këtë seancë, po ashtu kolegu Lako është prezent online dhe na është bashkuar në këtë seancë. Ndërkohë që në sallë jam unë relatori, Elvis Çefa, është Ledio Braho dhe zoti Ilir Rusmali. Është prezent përfaqësuesja e Komisionerit, Drejtoresha Juridike dhe stafi i saj në KQZ-ë. Nuk është prezent ankimesi. Është prezent dhe personi i interesuar, pra subjekti i interesuar në këtë procedim administrativ, që është përfaqësuesi ligjor i koalicionit zgjedhor “Bashkë Fitojmë”, z. Ivi Kaso. Atëherë sipas procedurës fillojmë shqyrtimin në themel të çështjes duke ia dhënë edhe njëherë fjalën përfaqësuesit të

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 2.08.2024*

Komisionerit Shtetëror, për të na relatuar në mënyrë të përmbledhur faktet dhe rrethanat e çështjes.

**Znj. M. Koja:** Faleminderit! Atëherë, Kryetari në detyrë i Bashkisë Himarë ka sjellë shkresërisht, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve informacionin lidhur me caktimin e qendrave të votimit në Bashkinë Himarë, për zgjedhjet e datës 4 gusht 2024. Në këtë shkresë është përcaktuar se vendndodhja e qendrës së votimit 4589/00 është ambienti publik, rruga “Xhorxh Tened”, nr.4, shkolla Spile, shkolla 9-vjeçare “Nikolla Pano Meniko”. KZAZ-ë nr.88, nëpërmjet kryetarit të saj ka përcjellë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve shqetësimin se ambienti në të cilin propozon pushteti vendor është jashtë hartës së zonës së qendrës së votimit nr.4589/00 dhe e bën votimin dhe pjesëmarrjen të paaksesueshme, duke marrë parasysh edhe moshën e madhe të shumicës së votuesve në atë qendër, temperaturat e larta, duke qenë se data e votimit është 4 gusht. Nga ana tjetër KZAZ ka pohuar dhe ka paraqitur deklaratë nga pronari i ambientit privat, z.Odhise Milo se ofron një ambient tjetër në pronësi të tij, për të shërbyer si qendër votimi. Duke qenë se në ambientin ku kanë zhvilluar zgjedhjet në vitet paraardhëse ai i ka kthyer në dhoma pushimi. Distanca e ambientit të ripropozuar nga ai, që ka qenë në zgjedhjet e mëparshme është në një distancë prej 7 metrash dhe sipas KZAZ-së plotëson kriteret ligjore për t’u përdorur si qendër votimi. Në lidhje me këtë propozim nga ana e KZAZ-së, KQZ ka kërkuar informacion nga Bashkia Himarë, e cila ka informuar se vendndodhja e re e qendrës së votimit, dhe nga vendndodhja e mëparshme dhe nga zona ku banojnë zgjedhësit e kësaj QV-je është në një distancë 2500 metra. Bashkia pohon se vendndodhja e re nuk është brenda zonës së qendrës së votimit, pra është në një zonë, qendre votimi tjetër dhe ka ndryshuar vendndodhjen për shkak se nuk ka ambient publik dhe as privat që mund të jepet me qira. Kjo e provuar nga pyetëtori, përcjellë me email, të

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 2.08.2024*

cilin ma keni dorëzuar. Nisur nga sa më sipër KQZ ka kryer verifikimet në terren në lidhje me këto propozime, ku ka verifikuar se ambienti i propozuar nga KZAZ-ja është afër me QV-në që ka shërbyer për disa procese zgjedhore. Nga sa referohet për rreth 13 procese zgjedhore të njëpasnjëshme si qendër votimi dhe zgjedhësit e kësaj qendre votimi kanë më shumë mundësi aksesit për të ushtruar të drejtën e tyre për të votuar. Ky ambient i propozuar nga KZAZ është më afër nga zgjedhësit. KQZ-ja ka administruar dakordësinë e pronarit të objektit, z. Odhise Milo, i cili është i gatshëm për të dhënë objektin për qendër votimi. Nga shqyrtimi i të dhënave dhe dokumentacioni i administruar rezulton se Bashkia Himarë nuk është në kushtet e ndryshimit të vendndodhjes së qendrës së votimit sipas rregullit të parashikuar nën 62, pika 4 të Kodit Zgjedhor, për shkak se mungojnë arsyet objektive. Kodi Zgjedhor parashikon që qendra e votimit ndryshon nga zgjedhjet paraardhëse vetëm kur ka arsye objektive. Gjithashtu KQZ-ja ka ndërmarrë inspektim në terren ku rezulton se vendndodhja e qendrës së re është caktuar në një ambient publik, distanca është ndërmjet 2500 dhe 3000 metra, me një kohëzgjatje mesatare udhëtimit të banorëve, 25-30 minuta, vajtje dhe po kaq në kthim. Referuar listës së zgjedhësve, rezulton që mosha mesatare e zgjedhësve të kësaj qendre votimi është 50 vjeç, nga 691 zgjedhës, rreth 312 zgjedhës janë të grup-moshës mbi 50 vjeç. Periudhat zgjedhore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor janë ndërmjet datave 15 prill - 15 maj apo 15 tetor – 15 nëntor. Duke pasur parasysh që zgjedhjet nuk mbahen në asnjë prej këtyre periudhave zgjedhore, por do të zhvillohen në sezon veror, me temperatura të larta dhe territorin e thyer, distanca e largët nga banesa në zonën e tyre të qendrës së votimit vështirëson aksesin dhe mundësinë e zgjedhësve të kësaj qendre votimi për të ushtruar të drejtën e votës. Në kushtet kur propozimi përmbush kriteret e përcaktuara në udhëzimin nr.1, datë 5.12.2020, të Komisionit Rregullator, rekomandohet që vendndodhja e qendrës së votimit të ndryshojë nga QV 4589/00

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt. 2.08.2024*

me adresë rruga “Xhorxh Tened”, nr.4, shkolla 9-vjeçare “Nikolla Pano Meniko” në QV nr.4589/00, me adresë Himarë, lagjja 1 Maji, rruga “Milto Kallushi”, ambienti privat i zotit Odhise Milo. Gjatë shqyrtimit në seancë, e cila u zhvillua në orën 12, u vlerësua se duke qenë se me kërkesë të subjekteve zgjedhore të cilët, një palë ishte dakord për ta ndryshuar vendndodhjen, ndërsa një pale tjetër, një subjekt zgjedhor tjetër nuk ishte dakord, atëherë u urdhërua nga Komisioneri për të marrë masa për ta riinspektuar në vend qendrën e votimit, duke qenë se subjekti zgjedhor “Partia Socialiste” pretendonte që objekti i propozuar nga KZAZ nuk i plotëson kushtet dhe kriteret. Në seancën e orës 18, të po asaj date, u raportua se nga kryetari i KZAZ-së konfirmohet përshtatshmëria e objektit në përputhje me kërkesat ligjore. Edhe nga inspektimi, riinspektimi në terren i KQZ-së, rezulton se ambienti i ka elementët për ta bërë atë funksional. Në këto kushte u miratua vendimi i cili është objekt shqyrtimi në këtë kërkesë ankimore. Faleminderit!

**Z. E. Çefa:** Po, ju falemnderit! Atëherë, shkurtimisht ia jap fjalën dhe përfaqësuesit të palës së interesuar, z.Kaso. Meqenëse ankimuesin nuk e kemi prezent.

**Z. I. Kaso, përfaqësues i Koalicionit BF:** Faleminderit zoti drejtues i seancës! Kam pak për të shtuar nga ajo që u relatua nga administrata dhe Drejtoresha Juridike. Kemi të bëjmë me një rast tipik, kur kryetari në detyrë i bashkisë, mbasi ka ezauruar kompetencën e vet që ia njeh ligji në funksion të arritjes së një interesi, të një rezultati zgjedhor dhe ngushtësisht për një interes politik, partiak, mendon që është më mirë që gjithë zgjedhësit e kësaj qendre votimi, meqenëse rezultati i qendrës së votimit nuk i pëlqen është më e arsyeshme që në datën 4 gusht, pjesa më e madhe e këtyre zgjedhësve siç u relatua, janë mbi moshën 50 vjeç. Nga informacionet tona janë rreth 60 vjeç e më sipër, të bëjnë 5 kilometra rrugë më këmbë në vend që të

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 2.08.2024*

votojnë në një qendër që është shumë pranë qendrës në të cilën ata janë mësuar që të votojnë në 13 procese zgjedhore të kaluara, pra pa asnjë problem dhe që është vetëm 7 metra larg qendrës së mëparshme. E cila për arsye të mënyrës së beftë se si dekretuan këto zgjedhje, kohës krejt të pamjaftueshme për të përgatitur, i pamundësuan pronarit të qendrës së votimit, i cili e kishte vënë në dispozicion më përpara që ta vinte në dispozicion në të njëjtat kushte, me të njëjtat terma. Them është kërkesë politikisht e motivuar sepse do ta kuptoni interesin gjenuin të një kryetari bashkie që donte më të mirën për zgjedhësit e vet, për qytetarët vet, donte që ato të votonin me standard. Ka vërtet hall që ajo që qendër është e vogël, ka vërtet hall që linja e korentit, që siç ngre në pretendimin e tij, pavarësisht se nuk ka një kontratë të veçantë për magazinën në emër të pronarit, por është, rezulton e lidhur me kontratën principale që është në emër të pronarit. Ka vërtet merak se kjo linjë u bie në kokë, ose ka vërtet merak se fjala vjen na prishet PEI dhe nuk mundet të votojnë zgjedhësit? Por më besoni që nuk është një kryetar bashkie, pavarësisht se në detyrë, i përkohshëm, që motivohet nga ndjenja të tilla fisnike dhe pse e them këtë? Nuk e them këtë sepse është i emëruar i Partisë Socialiste dhe që është palë në proces. Siç e thashë dhe më përpara ai kryetar në detyrë e ka mbaruar funksionin e vet në raport me zgjedhjet dhe kërkon të fusi hundët në atë që është funksion i KZAZ-së dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që është procesi i menaxhimit dhe mbikqyrjes së të çdo aspekti të procesit zgjedhor. Ka mbaruar punë bashkia, e ezauroi ai kompetencën! Nuk i ndërhyri njeri në kompetencë, siç ka bërë KQZ-ja më pas, ka përgjegjësinë, KZAZ-ja që ka përgjegjësinë, është punë e tyre, e para. E dyta, për të treguar standardin e këtij të përdëlyerit për standardet, kemi qendrën publike që na vendosur në fshatin Vranisht, qendra 4593/00. Këto janë fotografitë e qendrës së rrënuar që ky kryetar bashkie... Jo jo, lidhet ngushtësisht, lidhet se ka të bëjnë me motivin. Ngre arsye që thotë nuk ka kontratë kablli i korentit që kalon te magazina.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 2.08.2024*

Ndërkohë po ky kryetar në detyrë i paligjshëm bashkie cakton qendër votimi në këtë ambient, në këtë ambient të rrënuar. Fotot janë sot pasdite, pa filluar mbledhja. Pa dyer, pa dritare, pa energji. Ky është Arqile Bollano...

---

**Z. I. Rusmali:** Do na i paraqisësh si provë?

**Z. I. Kaso, përfaqësues i Koalicionit BF:** Patjetër...

---

**Z. I. Rusmali:** S'kanë lidhje me objektin.

**Z. I. Kaso, përfaqësues i Koalicionit BF:** Për mua kanë... Ju e vendosni me vendim kanë a s'kanë lidhje. Për mua kanë lidhje. Kanë lidhje me motivimin.

**Z. I. Rusmali:** Objekt i kërkesës...

**Z. I. Kaso, përfaqësues i Koalicionit BF:** Objekt i kërkesës është që ka bërë një person i paautorizuar, një horr zgjedhor, siç i kemi quajtur në raste analoge, kolegët e tij dhe ky është një horr zgjedhor që motivohet nga interesi, është gati të lërë një qendër të tërë pa votuar se rezultati nuk i pëlqen. Kjo është, thelbi i kërkesës që duhet të zgjidhni ju dhe thelbi i kërkesës që duhet të zgjidhni ju sot është, do ta legjitimoni një horr zgjedhor të hedhi në erë procesin e një qendre votimi se nuk i pëlqen rezultati, ndërkohë që në qoftë se do të zbatojë standardet ky është standardi i këtij horri zgjedhor ku i cakton qendrat e votimit, pa dyer, pa dritare, pa korent, pa asnjë gjë. Qendra e votimit 4593/00, në fshatin Vranisht e caktuar nga ky horr zgjedhor, kjo është mosmarrveshja që ju duhet të zgjidhni. Unë jam i mendimit që interesi i zgjedhësve për të votuar në një qendër votimi që e njohin, që kanë 13 palë zgjedhje

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 2.08.2024*

që votojnë, prevalon mbi interesin e horrit zgjedhor që nesër do të paditet në SPAK për veprën penale të pengimit të zgjedhësve për të votuar pavarësisht vendimmarrjes tuaj të sotme. Ju falemnderit!

**Z. E. Çefa:** Ju falemnderit z. Kaso! Nga kolegët pyetje? Po, zoti Rusmali.

**Z. I. Rusmali:** Kam vetëm një pyetje, në fakt dhe për zotin Kaso dhe për Drejtoreshën. Po së pari desha, domethënë mendoj që, është mirë që të regjistrohet në procesverbalin e kësaj mbledhje, një konstatim. Kjo trupë me shumë përpjekje dhe me lodhje në fakt ka arritur një standard etik, që është i admirueshëm dhe ka arritur që të realizojë në kohë të gjatë edhe një lloj edukimi të të gjithë pjesëmarrësve, përfshi dhe ne individualisht, që të jemi konkret dhe të fokusuar te objekti i çështjes. Ne i kuptojmë emocionet që kanë palët, që marrin pjesë në garë, janë të natyrshme. Një pjesë prej emocioneve dhe mund t'i ndajmë individualisht, por emocionet janë për tribunat politike, nuk janë për këtë tryezë. E mira është që... Pse nuk duhet të jetë për këtë tryezë? Nuk janë për këtë tryezë sepse çdo lloj ngjyrimi politik që i jepet shqyrtimit këtu, largon vëmendjen nga thelbi i çështjes. Thelbi i çështjes është gjithmonë juridik, është ose procedural ose material dhe nuk ka asnjë nevojë që njerëzit të ngrenë tonet, të hapin faqet e fundit të fjalorit për të bindur palën që i dëgjon. për argumentat e tyre, mjafton të hapin faqet e Kodit dhe të referojnë dispozitat. Tani unë u përpoqa nga ndërhyrja e zotit Kaso që të mbledh çfarë është ligjore në atë ndërhyrje dhe kam nevojë që z.Kaso të më japë një përgjigje sepse më duket sikur po më krijohet një kontraditë si me thëniet e Drejtoreshës dhe me dokumentat që kam këtu. Jemi përpara një situatë kur kryetari i bashkisë, qendrën e votimit tek shkolla, s'po i jap adresat se s'i mbaj dot mend, nga ambienti privat tek shkolla, e bëri në procedure transferimi apo e bëri në procedurë shpalljeje të

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 2.08.2024*

qendrave të votimit? Pra, e bëri akt fillestar apo e bëri më vonë? Sepse më duket sikur thatë, mbasi kishte ezauruar kompetencën e tij, bëri këtë veprim, ndërkohë që Drejtoresha na tha e ka shpallur tek qendra, pra si akt primar të vetin. Kemi kontraditë apo janë faktet që na kundërshtojnë z. Kaso?

**Z. I. Kaso, përfaqësues i Koalicionit BF:** Faleminderit! Kur ju referova “e ka ezauruar kompetencën e tij”, ju referova faktit që këtë qendër votimi e ka shpallur te shkolla e mesme, nga e cila është ndryshuar me autorizim, pra, në këndvështrimin tonë, thellësisht ligjor, në momentin, sipas nenit 62, e ka shpallur një herë, kryetari i bashkisë, i Partisë Socialiste, se thamë të mos jemi politik, po ai është politik dhe po politikisht..

**Z. I. Rusmali:** Është jashtë tagrit të tij..

**Z. I. Kaso, përfaqësues i Koalicionit BF:** Sigurisht që po...

**Z. I. Rusmali:** Unë e mora përgjigjen.

**Z. I. Kaso, përfaqësues i Koalicionit BF:** Po, për interes politik, në një moment që s’ka punë te procesi zgjedhor.

**Z. I. Rusmali:** Dakord. Nuk ka kontraditë faktesh midis asaj që shtjelloni ju dhe..

**Z. I. Kaso, përfaqësues i Koalicionit BF:** Për mendimin tim...

**Z. I. Rusmali:** ...asaj që shtjellon drejtoresha.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 2.08.2024*

**Z. I. Kaso, përfaqësues i Koalicionit BF:** Në dijeninë time...

**Z. I. Rusmali:** Ai nuk e ka caktuar njëherë te ambienti privat dhe e ka zhvendosur rrugës, ai e ka caktuar që në fillim tek shkolla.

**Z. I. Kaso, përfaqësues i Koalicionit BF:** Në dijeninë time, po.

**Z. I. Rusmali:** Dakord! Drejtore të lutem! Ju në shqyrtimin që i bëni vendimit të Komisionerit merrni dhe analizoni dhe unë besoj ndoshta dhe me të drejtë, faktin që për caktimin tek qendra, tek shkolla, të qendrës së votimit, pra, për zhvendosjen e qendrës së votimit, tradicionale nuk ka pasur shkaqe objektive. Ndërkohë që pika 4 kërkon që qendra të mbahet atje ku është votuar, në atë adresë ku është votuar tradicionalisht, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe objektive. Dhe ju keni nxjerrë një vendim për dhënie autorizimi për ndryshim. Tani dhe dhënia e autorizimit për ndryshim mbështetet tek pika 4 e nenit 62, tek fjalia e fundit e pikës 4. Autorizimi lëshohet kur ka forcë madhore, kemi rast të forcës madhore? Nuk po diskutoj se kush e bën kërkesën, po shkakun ligjor për autorizimin e kemi? Ka patur forcë madhore për të lëshuar autorizimin?

**Znj. M. Koja:** Sikundër u relatua dhe sikundër është përmendur në bazën ligjore të vendimit, neni 62, pika 4, është argumentuar dhe është disponuar me vendim, bazuar në atë që unë përmenda pak më lart. Pra, nuk gjejmë arsye objektive për ta ndryshuar.

**Z. I. Rusmali:** Jo forcë madhore.

**Znj. M. Koja:** Jo, forca madhore, në kuptim të legjislacionit shqiptar është gjë tjetër.

*Zbardhi materialin audio  
Adriang DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 2.08.2024*

**Z. E. Çefa:** Keni ndonjë pyetje? Në qoftë se ke...

**Z. L. Braho:** Një pyetje për administratën. Tani unë e kuptoj që kjo ka të bëjë me forcë madhore dhe këtu dhe ka fakte dhe normalisht janë të llogaritura, jo për zgjedhje të pjesshme, të parakohshme, po për zgjedhje normale. Tani, në qoftë se mund të ma shpjegoni: çfarë mekanizmi ka KQZ-ja në rastin kur një kryetar bashkie, le të themi lajthit dhe nuk e cakton qendrën e votimit sipas kritereve të përcaktuara në nenin 62 të Kodit Zgjedhor?

**Z. I. Rusmali:** Jo lajthit, po e shkel me dashje mor burrë.


**Z. L. Braho:** Po për mos ta thënë atë.

**Z. I. Rusmali:** Rrëshket me dashje.

**Z. L. Braho:** Kush është mekanizmi që ka KQZ-ja për ta zhbërë këtë shkelje të ligjit?

**Znj. M. Koja:** KQZ-ja në zbatim të nenit 62, pika 11 brenda afateve të përcaktuara në këtë nen, sigurisht për zgjedhje periodike të rregullta, ndërhyjnë kryesisht ose me ankesë të përfaqësuesit të partive për të zbatuar kërkesat, kriteret për qendrën e votimit. Në këtë kuptim ka vendosur, ka disponuar me vendim të Komisionerit dhe sigurisht që këtë vendimmarrje, ai e mori pas një hetimi të kujdesshëm administrativ, për të pyetur bashkinë në lidhje mbi arsyet që e shtynë Kryetarin në detyrë të bashkisë për të ndryshuar qendrën e votimit, nga ajo historike tek qendra e re e votimit. Janë drejtuar disa pyetje, nëse vendndodhja e re është brenda një territori kompakt dhe të pashkëputur gjeografik për QV-në dhe bashkia është përgjigjur me

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*






*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 2.08.2024*

përgjigje po, pozitive. Është pyetur në lidhje me distancën, ku bashkia pohon që janë 2500 metra larg. Është pyetur nëse vendndodhja e re e QV-së është brenda zonës të qendrës së votimit, përgjigja e bashkisë ka qenë jo. Cilat janë arsyet, bashkia pohon që nuk ka ambient publik dhe as privat që mund të jepet me qira dhe arsye është që mosgjetja. Pra, pyetjes se cilat janë arsyet specifike që çuan në ndryshimin e vendndodhjes, nga një ambient privat në atë publik, përgjigja është mosgjetja e një ambienti të përshtatshëm privat ose publik, por nuk i provon bashkia nëse ka pasur komunikime me pronarin e ndërtesës që ka shërbyer si qendër votimi historike. Më pas pyetjeve a ka arsye objektive? Arsye objektive ajo përmend kthimin e objektit në strukturë hotelerie dhe këtë e dimë që struktura ku ka qenë qendra e votimit nuk është e njëjta me atë me vendimmarrjen e Komisionerit, por është një strukturë në distancë 7 metra larg asaj ekzistuese. Më pas pyetjeve a janë përmbushur kriteret, ka një listë shteruese me dokumente, arsyetime që provojnë pamundësinë e caktimit në këtë ambient? Është përgjigjur me po, bashkia, por nuk e ka provuar këtë, pra të ketë një komunikim shkresor me pronarin e qendrës së votimit që ka shërbyer dhe më parë. Pyetjes si është siguruar vendndodhja e re, ofron akses të lehtë e të barabartë për të gjithë votuesit? i është përgjigjur që është një ambient publik, shkollë me dy kate, ku ka dy QV-ë ekzistuese, ku përmbushen kriteret për QV-ve.

**Z. L. Braho:** Po kjo shkolla me dy kate mund të ishte dhe në Tiranë po nuk është fakt, që është shkolla me dy kate, por domethënë, jo që kuptoj unë është që vendimmarrja në thelb është bërë në bazë të pikës 11 të nenit 62, pavarësisht se bazë ligjore dhe titull vendimi është përdorur 62, pika 4...

**Znj. M. Koja:** Është hetuar.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 2.08.2024*

**Z. L. Braho:** ...pra, janë hetuar, me çfarë kuptoj unë nga Komisioneri të gjithë kriteret e qendrave të votimit dhe sipas Komisionerit kjo qendër e caktuar nga kryetari i bashkisë nuk plotëson kriteret dhe për këtë arsye është vendosur në këtë rast të jepet autorizimi por që...

**Znj. M. Koja:** Nuk është ekzaktësisht qendra që ka miratuar kryetari i bashkisë, nuk i plotëson kriteret, po qendra që ka miratuar kryetari i bashkisë nuk i plotëson kriteret, por nuk i jep akses lehtë..

**Z. L. Braho:** ... po pra lidhet..

**Znj. M. Koja:** ...sikundër distanca e largët..

**Z. L. Braho:** jep... kanë lidhje me.. që nuk ndodhet brenda një territor kompakt, të pashkëputur gjeografik besoj, kjo është...

**Znj. M. Koja:** Nuk është brenda zonës që qendrës së votimit.


**Z. L. Braho:** Dakord.

**Znj. M. Koja:** Është në një zonë të një qendre votimi tjetër.

**Z. L. Braho:** Qartë. Dakord, faleminderit!

**Z. I. Rusmali:** Ju keni inspektuar, siç e kuptova unë, keni inspektuar, keni çuar njerëz në terren dhe keni inspektuar ambientet, edhe magazinën, edhe shkollën. Çfarë

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 2.08.2024*

konkluzioni kanë arritur inspektorët, jo Kryetari i Bashkisë? Inspektorët për përshtatshmërinë e magazinës?

**Znj. M. Koja:** Sikundër u relatua dhe është pjesë dhe e relacionit të këtij projektvendimi, është relatuar në seancën publike të Komisionerit. Nga inspektimi dhe riinspektimi që u bë brenda ditës që është dita e vendimmarrjes, inspektorët e KQZ-së konkludojnë që i plotëson kriteret ligjore për të qenë qendër votimi. Flasin për ambientin privat që është në afërsi 7 metra nga qendra ekzistuese.

**Z. I. Rusmali:** Magazina?

**Znj. M. Koja:** Magazina.

**Z. I. Rusmali:** S'ka ndonjë të keqe edhe te magazine mund të bëhen zgjedhjet, s'ka ndonjë problem.

**Znj. M. Koja:** Në fakt...

**Z. I. Rusmali:** Boll të ketë kushte të përshtatshme.


**Znj. M. Koja:** Po.

**Z. I. Rusmali:** Nuk ka ndonjë problem.

**Znj. M. Koja:** Në fakt është një ambient...

**Z. I. Rusmali:** Pse quhet magazinë nuk është përbuzës, është...

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 2.08.2024*

**Znj. M. Koja:** Jo në fakt...

**Z. I. Rusmali:** Ka funksionin magazinë.

**Znj. M. Koja:** Ambienti është një koridor me dy dhoma, një ..

**Z. I. Rusmali:** Dakord.

**Znj. M. Koja:** ...një në krahun e majtë një në të djathtë, ky i djathti ekzaktësisht është magazinë, ka qenë dhe i majti...

**Z. I. Rusmali:** Pa asnjë problem..

**Znj. M. Koja:** ...i ka transferuar.

**Z. I. Rusmali:** Pa asnjë problem. Magazina mund të jenë ambient më i madh se një klasë shkolle dhe po qe më i madh është akoma më i përshtatshëm, nuk do të thotë asgjë. Dakord. Po pse nuk ka urdhëruar, pse nuk ka vendosur Komisioneri që të urdhërojë transferimin, pse ka thënë vendim për transferimin e qendrës së votimit nga kjo adresë në këtë adresë?

**Znj. M. Koja:** Në lidhje me këtë sa ju pyesni, në fakt KQZ-ja sa herë ka disponuar me vendimmarrje për të ndryshuar qendrat e votimit, për të caktuar një të re, ka autorizuar autoritetin, që ka kompetencën për të përcaktuar qendrën e votimit, që është kryetari i bashkisë në këtë rast, për ta ndryshuar vendndodhjen. Pra, ishte dhe bëhet, të themi.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 2.08.2024*

**Z. I. Rusmali:** Dakord. Po, procedura e pikës 4 nënkupton bashkëveprim midis organit që ka kompetencën dhe KQZ-së, do të thotë ndërveprimi, nisma merret nga organi që ka kompetencën, i cili konstaton që jemi përpara forcës madhore dhe nuk mund të zhvillohen zgjedhjet në një qendër votimi, është prishur qendra e votimit, na duhet një tjetër dhe jemi jashtë afateve ligjore për këtë qëllim kërkon autorizim zhvendosjeje. Ne siç e konstatojmë nuk jemi në rastet e forcës madhore por neni, pika 11 e nenit lejon Komisionerin që të vendosë ai për ta ndryshuar kur konstaton që caktimi është bërë jashtë kushteve dhe kritereve të ligjit. Në raportin tuaj fakti që një qendër është zhvendosur nga pozicioni i vet tradicional është kusht ligjor, është kusht! Kryetari i bashkisë kur e ka zhvendosur nga pozicioni e vet ligjor, thotë Komisioneri, nuk ka pasur shkak ligjor për ta zhvendosur, do të thotë ka shkelur këtë kusht dhe shkelja e kushtit është shkak i mjaftueshëm për Komisionerin për të vendosur transferimin. Pse nuk bëhet në këtë formë? Kur është gjithë konteksti i dispozitës është aty. Pika 11 e nenit është aty.

**Znj. M. Koja:** Kështu është vlerësuar nga ana e administratës për t'u propozuar.

**Z. I. Rusmali:** Dakord! T'ju bëj dhe një pyetje tjetër? Tani kjo është, domethënë ne kemi nevojë për ndihmë, kjo nuk është pyetje për faktet dhe rrethanat. Faktet dhe rrethanat se duket faktet dhe rrethanat janë të qarta, por është për procedurën ligjore. Në qoftë se ne do të donim ta saktësonim këtë vendim, ta korigjonim, ta bënim sipas pikës 11, mund të bëhet kjo në procedure korigjimi akti? Apo duhet që ne të marrim një vendim ku të kërkojmë Komisionerit që të nxjerrë vendim për transferimin brenda një afati të shkurtër, cila është rruga ligjore më e përshtatshme, në vlerësimin tuaj si administratë?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 2.08.2024*

**Znj. M. Koja:** Ky është një mendim imi personal, të paktën dhe duke vlerësuar kompetencat e KAS-it. Unë mendoj që KAS-i mund të disponojë drejtpërdrejt me nxjerrjen e një vendimi, që rregullon, ndreq atë që mund të jetë e shprehur jo saktësisht në vendimin e Komisionerit, duke disponuar me një vendim që rregullon pasojat.

**Z. I. Rusmali:** Po, kjo praktikisht do na detyronte ne që të merrnim përsipër kompetencën për verifikimin e kushteve objektive, ndërkohë që kompetenca është e Komisionerit.

**Znj. M. Koja:** Kushtet objektive janë ato që administrata verifikon...

**Z. I. Rusmali:** Dakord po ka verifikuar për llogari të Komisionerit po jo për llogari ton. Praktikisht ne do duhet të futeshim në një procedurë sui generis, duhet të ndërprisnim ne mbledhjen, të shkonim në Himarë dhe bënim ne verifikimet se ne administratë nuk kemi.

**Znj. M. Koja:** Janë ato foto që unë dërgova, ato janë foto të dërguara nga inspektorët pas riinspektimit që u bë ndërmjet orës 12 të vendimmarrjes, të shqyrtimin të seancës, seancën e orës 18 në kuadër të asaj dite. Është relacioni shoqërues i projektvendimit.

**Z. E. Çefa:** Kolegu Lako, meqenëse je në distancë, keni ndonjë pyetje, ndonjë diçka apo ?

**Z. E. Lako:** Jo për momentin nuk kam.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 2.08.2024*

**Z. E. Çefa:** Dakord, faleminderit! Dakord. Pyetje të tjera?

**Z. I. Rusmali:** Jo.

**Z. L. Braho:** Jo.

**Z. E. Çefa:** Nuk ka pyetje të tjera, atëherë do të kalojmë në konkluzione përfundimisht. Administrata pra, përfundimisht qëndrimin tuaj ju lutem?

**Znj. M. Koja:** Ne kërkojmë rrëzimin e kërkesës ankimore. Faleminderit!

**Z. E. Çefa:** Ju faleminderit! Atëherë z. Kaso?

**Z. I. Kaso, përfaqësues i Koalicionit BF:** Rrëzimin e kërkesës ankimore.

**Z. E. Çefa:** Ju faleminderit! KAS tërhiqet për vendim, do të na duhen rreth 15 minuta. Duke pasur parasysh dhe orën e vonë, do të mundohemi për 15 minuta ta mbyllim dhe të ritakohemi këtu. Faleminderit!

**Rifillon seanca**

**Ora 22:13**

**Z. E. Çefa:** Përshëndetje dhe një herë. Riçelim seancën për shpalljen e vendimit lidhur me kërkesën ankimore me nr.8. KAS pasi e diskutoi çështjen në tërësi, me shumicë votash vendosi:

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 2.08.2024*

- Pranimin e pjesshëm të ankimit. Ndryshimin e vendimit nr. 159, datë 1 gusht 2024 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Bazuar në pikën 11 të nenit 62 ë Kodit Zgjedhor, ndryshimin e vendndodhjes së qendrës së votimit nr.4589/00 nga shkolla 9-vjeçare “Nikolla Pano Meniko” Spile, Rruga “Xhorxh Tened” nr.4, në ambientin privat në pronësi të shtetasit Odhise Milo me adresë Himarë, lagjja 1 Maji, rruga “Milto Kallushi”.
  - Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe KZAZ-ja nr.88, e Bashkisë Himarë.
  - Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
  - Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin Zgjedhor brenda afateve të përcaktuara në aktet nënligjore të Komisionit Rregullator.
  - U shpall sot në datën 2 gusht 2024, në orën 22:15.
- Me kaq e deklarojmë seancën të mbyllur.

**Vendimi nr. 15**

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*

